

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

SUPERFUQIA NË ALLAHUN

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

العزة فالله

Titulli:

SUPERFUQIA NË ALLAHUN

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2008

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përshtëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përshtëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Ajo çka po ndodhë për çdo ditë tek muslimanët si: nënçmimi i ndërsjellët, urrejtja në mes vete, problemet, ndarja, përçarja, copëtimi, konfrontimi, hidhërimi etj., të gjitha këto na obligojnë neve që patjetër t'i lëmë dhe të largohemi prej kundërshtimeve mes vete, konfrontimeve, hidhërimeve, nënçmimeve.

Të gjitha këto na obligojnë të mbjellim parimin e vëllazërimit dhe çlirimin e zemrave në gjokset tonë, para se të bëhet vonë dhe para se të na shkojë jeta pa bërë punë të mira. Të gjitha këto na

obligojnë domosdoshmërinë e kthimit sa më shpejt tek Allahu Gjithëfalës dhe i Gjithëfuqishëm; t'i lëmë anash konfrontimet, kundërshtimet, hidhërimet, nënçmimet dhe t'i lutemi Allahut që t'i lartësojë dhe t'i ngritë muslimanët edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, njëherit t'i mbrojë muslimanët nga nënçmimi, poshtërimi, ndarja, përçarja dhe shpërndarja.

Le të jetojnë në këtë dunja (botë) me nderë, fuqi, zhvillim dhe qeverisje, ndërsa në botën tjetër me vendbanimet me të larta të Xhenetit dhe shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të jetë vërejtje dhe dëshmi se vërtetë - ***“Allahu kurrë nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre.”*** (Err Rra`d, 11)

Deri sa të arrijmë me këtë parim (maksimë) në çështjet më të rëndësishme dhe më madhore, përpos një pjese që i ka mbrojtur Allahu dhe i ka mëshiruar nga të tjerët, të tjerët janë në shkatërrim të zemrave të tyre dhe të muslimanëve, duke shkaktuar kundërshtime, konfrontime, ndarje dhe përçarje. Duhet të angazhohemi që ta heqim këtë ves të keq dhe virusin shkatërrimtar për të kaluar jetë të lumtur, të qetë dhe të mirë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Për t'u angazhuar në përmirësimin dhe ndryshimin e gjendjes faktike të mjerueshme, e për të arritur në një gjendje të ndershme, të lartë, të ndërtuar mbi bazat e vëllazërimit, unitetit, fuqisë, krenarisë,

deri tek triumfi dhe qeverisja Islame dhe e muslimanëve.

“Vërtetë Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli deri sa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre”.

(Err-Rra’d, 11)

* * *

SUPERFUQIA NË ALLAHUN

Domethënia “Izet” (krenari - superfuqi)

“Izet” (Krenari) do të thotë që çdo pjesëtar i umetit ta ndiejë veten krenar (të fuqishëm). Mirëpo, kjo krenari (fuqi) nuk duhet që të jetë në interes individual, si për reputacion, pozitë, fis, por kjo krenari duhet të jetë burim prej Allahut të Lartmadhëruar dhe në adhurim ndaj Allahut, duke u larguar prej mëkateve, duke iu frikësuar dënimit të Allahut për ngecje dhe lajthitje. Nga këtu buron edhe lutja e dijetarëve të mëhershëm:

“O Zoti im, më ndero me dëgjueshmëri ndaj Teje, e mos më nënçmo me mëkatet e mia ndaj Teje”.

E, vërtetë, krenaria (fuqia) duhet të jetë në nënshtrim ndaj urdhrave të Allahut, ndërsa nënçmimi dhe poshtërimi prej mospërfilljes së urdhrave të Tij. Kush dëshiron nderë dhe krenari, ai le t’i respektojë urdhrat e Allahut të Lartmadhëruar dhe le të largohet prej mëkatit ndaj Tij. Poeti thotë:

Krenaria në respekt të Gjithëfuqishmit,

E kush i robërohet robit, Allahu e nënçmon atë.

Mirëpo, krenaria duhet të jetë për Allahun, jo për vete, as për epshin, as për emocionet dhe fitimin e cekët.

Vëlla!!

Allahu nuk lejon për t'iu nënshtruar njerëzve (robërve). Nënshtrimi duhet të jetë vetëm ndaj Allahut, Zotit të vetëm, i Cili nuk ka rival. Madhështia i takon vetëm Atij, sexhde i bëhet vetëm Atij, nuk lejohet për t'i rënë në sexhde, as në ruku, askujt tjetër pos atij.

Allahu nuk lejon për t'iu nënshtruar askujt prej robërve të Tij, pos dy personave, mirëpo nënshtrimi (butësia) ndaj tyre në të njëjtën kohë është nënshtrim (butësi) ndaj Allahut, pra do të thotë KRENARI. Pra, nënshtrimi ndaj atij, të cilin e ka fënikëruar Allahu, është nënshtrim i urdhrave të Tij. Pra, nuk lejohet për t'iu nënshtruar askujt prej krijesave të Tij, pos dy personave, e ata janë:

1. Prindërve

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nënshtroji krahët tu (bëhu i butë) ndaj tyre me mëshirësi dhe thuaj: O Zot, mëshiroji ata dy, ashtu siç më kanë lehtësuar dhe janë kujdesur ndaj meje në vegjëli”. (El-Isra, 24)

2. Vëllezërve në fe

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Do të sjellë Allahu një popull të cilin do ta dojë dhe do ta donë Atë (Allahun), ata do të jenë të mëshirshëm dhe të nënshtruar (të butë) për besimtarët, ndërsa të ashpër ndaj pabesimtarëve”.

(El-Maide, 54)

Vëlla!!

Nuk të lejohet që t'i nënshtrohesh askujt tjetër, pos nënës tënde, babait tënd dhe vëllezërve të tu në islam. Ky nënshtrim i mëshirësisë, fisnikërisë dhe krenarisë është shpërblim dhe fitim i xhenetit, dhe largim prej dënimit të xhehenemit.

- Prej shkaqeve të nënshtrimit

Vërtet Allahu i Lartmadhëruar nuk e lejon për t'iu nënshtruar askujt, pos Zotit Një, i Cili nuk ka rival as ortak.

Ti je rob i Krijuesit, e jo rob i krijesës, ti je rob i vetëm i Allahut Një, i Cili nuk ka shok, as rival, për këtë edhe je i krijuar, për këtë je i urdhëruar. Nëse kësaj i përmbahesh, ti veç ke fituar dhe ke shpëtuar.

Për këtë edhe shohim se kur robi nënçmohet, torturohet apo i bëhet padrejtësi, i hapen atij dyert e qiellit dhe Allahu i Lartmadhëruar e pranon lutjen e tij, i përgjigjet, dhe i ndihmon, dhe në mes tij dhe Zotit nuk ka kurrfarë perde a pengese, por e ngritë lart mbi re, sepse Zoti i Lartmadhëruar nuk është i kënaqur që robërit e Tij të jenë të nënshtruar te dikush tjetër, pos te Ai.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Tre personave nuk i refuzohet lutja: Agjëruesit deri sa të fillojë iftarin, imamit të drejtë dhe lutja e atij, të cilit iu është bërë padrejtësi. Lutjet e tyre Allahu i ngritë mbi re, i hapë dyert qiellore dhe po ashtu Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Pasha madhërinë Time, do të të ndihmoj gjithsesi edhe pse do të vonoj pak”.

(Suneni i Tirmidhiut, 33522, hadithi hasen)

Vëlla!!

Në këtë hadith Allahu i Lartmadhëruar e ka përmendur fuqinë, për të dëshmuar se njeriut pa marrë parasysh çfarë padrejtësie i bëhet, ai të mos i nënshtrohet askujt tjetër, pos Tij, sepse Ai është i Fuqishëm, Ngadhënjimtar, Zgjdhës i problemeve, Largues i brengave, Shkatërrues i kriminelëve dhe i zullumqarëve, dhe Ndihmëtar i të dobëtëve, dhe i atyre të cilëve iu është bërë padrejtësi.

Kjo nuk do të thotë se Allahu i Lartmadhëruar e ka harruar atë, të cilit iu është bërë padrejtësi. Jo, Allahu i Lartmadhëruar nuk harron, por jep rast për të padrejtin të drejtohet dhe atij, të cilit iu është bërë padrejtësi të pret një afat të caktuar. Ai, Allahu Një, cilindo e ngritë dhe cilin do e ulë, Ai ka mundësi për çdo send. Këtë parim duhet mbjellë në mendjen e njerëzve; patjetër duhet të dimë se fuqia (ngritja) dhe

dobësia (poshtërimi) janë prej Allahut si në persona ashtu edhe në shoqëri.

- Si poshtërohet njeriu?!

Njeriu poshtërohet për 4 çështje:

1. DORËZIMI NDAJ SHEJTANIT,

respektimi i tij dhe kundërshtimi e moszbatimi i urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar. Vërtet, njeriu kur veten ia len në dispozicion shejtanit dhe e kundërshton Allahun, Allahu e bën të nënçmuar, të poshtëruar, të dobët dhe të varfër.

Analizo dhe vështro shejtanin, kur e ka kundërshtuar urdhrin e Allahut dhe ka refuzuar për t'i rënë në sexhde Ademit a.s., i ka thënë Allahut të Lartmadhëruar:

“A e sheh këtë [njeri – (njerëzimin)], të cilin e ke fisnikëruar dhe e ke ngritur mbi mua, nëse më jep afat, deri në ditën e kijametit, unë do t'i lidhë për frerin tim dhe do t'i përvetësoj, me përjashtim të një pakice”.

(El-Isra, 62)

Çka do të thotë “Le ehtenikene”?

Kjo fjalë burimin e ka prej “frerit”. Thuhet: “është frenuar kali”, “është frenuar kafsha”, pra i është vendosur freri në qafë. Pra, shejtani dëshiron të vendosë frerin në qafë të çdo njeriu për të tërhequr për në zjarr, sikurse ndonjëri prej nesh e tërheqë kafshën për në ahur.

Çështja e parë, e cila të bënë të poshtëruar është, kur ti je bërë pronë dhe rob i shejtanit, i je dorëzuar atij, të cilin e ka mallkuar Allahu i Lartmadhëruar.

Vëlla!!

Kurrë mos mendo se mëkati është i mirë dhe i kënaqshëm, përkundrazi është dobësi, nënçmim, varfëri, shkatërrim dhe dënim edhe pse ti ndien kënaqësi. Ta dish se ajo është kënaqësi e përkohshme dhe kalimtare, ajo është vetëm një pëlhurë e armikut tënd, shejtanit, sepse, ai dëshiron që të të shkatërrojë dhe të të poshtërojë, që ti të mos kesh në jetën tënde pavarësi në të menduarit dhe pavarësi në jetën tënde. Në vend se ti të kesh sundim mbi të, ai bëhet udhëheqës i yti, sa që të urdhëron për mëkat, e ti bën mëkat, kështu që poshtërohesh, e kundërshton dhe e humb edhe këtë botë, edhe botën tjetër. Të urdhëron t'i ngacmosh vajzat, të urdhëron për t'i shikuar gratë e huaja dhe atë çka e ka ndaluar Zoti i Lartmadhëruar; të urdhëron për prostitucion, vjedhje; të urdhëron për t'i dëgjuar gjërat e ndaluara, si: këngët, muzikën, në shikimin e programeve të ndaluara televizive; të urdhëron që ta humbësh kohën dhe jetën tënde; të urdhëron për t'u sjellë ashpër ndaj prindërve; të urdhëron të gënjesh, të shpifësh, të përgojosh, të pishë alkool, duhan, ndërsa ti vazhdimisht i vepron ato dhe e dëgjon, kështu ti bën mëkate vazhdimisht,

poshtërohesh dhe e shpien veten tënde në xhehenem të kësaj bote, dhe të botës tjetër.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAHIL ALIJJIL
ADHIJME

2. PASIMI I EPSHEVE

Ajo çka e bën njeriun të poshtëruar është pasimi i epsheve të tij, të cilat epshe e udhëheqin në rrugën e shkatërrimit, humbjes dhe mëkatit, sa që epshet e tij i bën zot. Zoti na ruajt!

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“A e ke parë atë, i cili epshet e tij i ka bërë zot”.

(El-Furkan, 43)

Shembull, kur njeriu kënaqësitë e kësaj bote i ka qëllim kryesor, pa marrë parasysh a e kundërshton Allahun apo jo, ky njeri kënaqësitë e kësaj bote, të përkohshme, të lehta, të cekëta, të poshtra, të cilat te Allahu Lartmadhëruar nuk peshojnë as sa fleta e mizës, i konsideron Zot të tij.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH

Për këtë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë:

“Ka humbur robi dinarin dhe dërhemin, mallin, rrobat e mëndafshita e kadife, nëse i epet kënaqet, nëse nuk i epet nuk kënaqet”.

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Është shkatërruar robi i dinarit, robi i dërhemit dhe robi i rrobave të mëndafshta, sepse nëse i epet kënaqet, nëse nuk i epet hidhërohet, ka humbur dhe është shkatërruar, e nëse ankohet nuk i merret parasysh ankimi”.

(Sahih buhari, 2673)

Imami, dijetari i njohur dhe shëmbëlltyra për xhihad, Shejhul Islam – Ibni Tejmije thotë:

“I robëruar është ai, i cili e ka bllokuar zemrën e tij në raport me Zotin e tij, ndërsa i pranguar është ai, i cili është pranguar prej epsheve të tij”.

3. NEGATIVITETI, AGRESIVITETI , HUMBJA E NDJENJAVE DHE SHPRESAVE PËR ARDHMËRI, MOSVENDOSMËRIA NË FENË E TIJ NË THIRRJE PËR FENË E TIJ DHE PLANPROGRAMIN E UMETIT TË TIJ

Ajo çka e bën njeriun të poshtëruar është negativiteti, influenza, ai nuk merr pjesë në shërbim të fesë dhe umetit të tij, nuk ka qasje në realitetin e umetit, është indiferent ndaj vetes së tij në atë se si do ta sheh veten e tij në botën tjetër, si do të jep llogari, si do të jetë xhehenemi, xheneti, duke mos punuar dhe duke mos bërë përgatitje për botën tjetër. Ai jeton si egërsirë, pa menduar, pa logjikuar; ai nuk ka

qëllim, nuk kujdeset për popullin e tij, nuk kujdeset për Kur'anin, as për sunetin, nuk kujdeset për vështirësitë, dhembjet dhe pikëllimin e umetit, nuk urdhëron në punë të mira, nuk i parandalon punët e këqija, nuk thërret në rrugën e Allahut, nuk u ndihmon muslimanëve për Allahun, as palestinezëve, as çeçenëve, as irakianëve, as Mesxhidi Aksasë së okupuar, nuk gëzohet me gëzimin e muslimanëve, nuk pikëllohet me pikëllimin e muslimanëve!

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BILAHIL ALIJJIL
ADHIMË

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ju jeni populli më i miri në ekzistencë për njerëzit, sepse urdhëroni në punë të mira dhe parandaloni nga punët e këqija dhe krimi, dhe besoni në Allahun”.

(Ali Imran, 110)

Vëlla!!

Do të jesh i nënçmuar nga shkaku se nuk ke interesim, as ndjenja për vlerën që ka planprogrami yt madhështor, nuk ke ndjenjë e as interesim për vlerën e mesazhit tënd, me të cilën të ka graduar Allahu i Lartmadhëruar, që ti ta kryesh. Ti ke Kur'anin, mirëpo nuk ia di vlerën dhe nuk punon me të; ti ke sunetin, mirëpo nuk ia di vlerën dhe nuk punon me të.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BILAHIL ALIJJIL
ADHIMË

4. BESIMI I DOBËT NË ALLAHUN E LARTMADHËRUAR DHE VENDOSMËRIA NË BESIM

Ajo çka e bën njeriun të nënçmuar dhe të poshtëruar është besimi i dobët në Allahun e Lartmadhëruar. Besimi duhet që të jetë udhëheqës i yti në vendosmëri në Allahun, e jo me qenë: i lidhur në dikë tjetër, pos në Allahun e Lartmadhëruar, i mbështetur në dikë tjetër, pos në Allahun e Lartmadhëruar, mbështetja e furnizimit në dikë tjetër e jo në Allahun e Lartmadhëruar, të frikësuarit ndaj dikujt tjetër e jo ndaj Allahut Lartmadhëruar, duke menduar se jeta e tij dhe vdekja e tij është në dorë të tjetër kujt, pos Allahut.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BILAHIL ALIJJIL
ADHIJME

Vëlla!!

Analizo këtë thënie të të Dërguari s.a.v.s., ndoshta do të jesh i kënaqur dhe do të krenohesh në Allahun e Lartmadhëruar.

Ebi Umumet r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet Shpirti i Shenjtë (Xhibrili) e ka vulosur në zemrën dhe shpirtin tim se asnjë njeri nuk mund të vdes pa e plotësuar exhelin (afatin e jetës së tij), dhe pa e harxhuar apo shpenzuar rizkun (furnizimin) e caktuar të Tij. Frikësojuni Allahut dhe kërkonj prej Tij, mos e lejoni veten për të mos kërkuar

rizk prej Allahut e pastaj të kundërshtoni dhe të mos i përfillni urdhrat e Allahut. Vërtet prej Allahut përfitohet duke respektuar urdhrat e Tij”.

Pra, ... Kur do të jesh i nënçmuar?!

Do të jesh i nënçmuar atëherë kur bëhesh rob i shejtanit, rob i epsheve të tua, rob i të këqijave, rob i materializmit; atëherë kur humb besimin në fenë tënde, planprogramin tënd, thirrjen në fenë tënde, dhe umetin tënd; atëherë kur të bëhesh rob i besimit të dobët dhe të humbësh besimin në Allahun e Lartmadhëruar.

Vëllezër!!

Keni kujdes nga këto rrethana dhe mos iu nënshtroji rrethanave e të bëheni rob të atyre, sepse kush robërohet do të jetë i shkatërruar, dhe armikun do ta vendosë mbi kokën e vet, për të qenë i nënshtroar dhe i nënçmuar.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH

Vëllezër!!

Në të kaluarën, saktësisht në epokën tatare, kanë mbizotëruar shkaqet e nënçmimit, nënshttrimit dhe poshtërimit të disa muslimanë, dhe kjo i ka shkatërruar ata, i ka bërë të ultë, sa që një grua (femër) i ka sunduar dhe i ka vrarë!

Një grua tatare ka shkuar të dhjetë muslimanë dhe u ka thënë atyre: Nuk kam me vete shpatë që t'u

vras të gjithëve, por mos lëvizni, pritni këtu derisa të shkoj ta marr shpatën dhe t'u pres. Nga frika e madhe prej tatarëve në atë kohë nuk kanë lëvizur, por kanë pritur derisa u ka ardhur gruaja dhe i ka mbytur ata.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BILAH

SHEMBUJ TË FORCËS NË UMETIN TONË

Ebu Bekri Sidiki

Me vdekjen e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. kanë lindur dhe janë shtuar problemet. Në Medine filloi në masë të paraqitet hipokrizia, disa prej fiseve arabe në Medine u larguan nga feja, disa penguan dhe refuzuan dhënien e zekatit të Ebu Bekri Sidiki, nuk kishte vend për faljen e namazit të xhumasë, pos në Meke dhe në Medine. Në këtë atmosferë dhe në këto kushte njerëzit kërkuan prej Ebu Bekri Sidikit që mos ta dërgojë Usamen r.a. udhëheqës të ushtrisë në misionet tjera, sepse ata kishin nevojë për të në Medine. Këtij propozimi dhe kësaj kërkesë iu bashkua edhe Omer bin el Hatabi, mirëpo Ebu Bekri Sidiki kategorikisht nuk pranoi, por tha: *“Për Zotin, nuk lëshoj pe në atë çka ka vendosur i Dërguari i Allahut s.a.v.s., po që se edhe orlët dhe egërsirat e kaplojnë, dhe e rrethojnë Medinën, po që se edhe qentë kalojnë mbi trupat e nënave muslimane, unë do ta dërgoj në ekspeditë Usamen me ushtri”*.

Në një transmetim tjetër thuhet: *“Pasha Atë (Allahun), në dorën e të Cilit është shpirti i Ebu Bekrit, po të mendoja se egërsirat më kapin do ta kisha dërguar ekspeditën e Usames, ashtu si e ka emëruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s., por edhe po të kisha mbetur i vetmi, prapë do ta ekzekutoja urdhrin e tij”*.

Aq shumë është kujdesur për të realizuar urdhrin e të Dërguarit të Allahut dhe aq shumë e ka respektuar, dhe e ka nderuar Usamen, sa që kur ka dalë për të shikuar ushtrinë e përgatitur, Usame ishte i hipur në kalë, Usame i thotë: *“O Halife i të Dërguarit të Allahut! Ose edhe ti hip në kalë, ose unë po zbres që të ecim së bashku”*. Ebu Bekri Sidiki i thotë: *“Për Zotin, as unë nuk do të hipi, por as ti nuk do të zbresësh”*.

Në një transmetim thuhet: *“Për Zotin, as ti nuk do të zbresësh, por as unë nuk do të hipi në kalë, po çka në se unë i pluhurosi këto dy këmbët e mia për disa çaste në rrugën e Allahut”*.

Ushtria filloi rrugën për në ekspeditë, ndërsa po kjo ushtri ka korrë suksese dhe ka fituar islami, dhe muslimanët sa që në çdo vend prej vendeve, dhe në çdo lagje prej lagjeve arabe ka pasur siguri, dhe qetësi, dhe nuk ka guxuar kush t'i frikësojë muslimanët, dhe çdo kush i cili ka tentuar ka hasur në rezistencë të fortë.

Vëllezër!!

Shikoni trimërinë, guximin dhe forcën e Ebu Bekri Sidikit, se si ka vepruar ai për ta ngritur islamin dhe muslimanët!

Kjo është mostër për të vepruar në të njëjtën mënyrë si Ebu Bekri Sidiki, i cili ka qenë guximtar, i çeliktë dhe si është përkujdesur për mbrojtjen e islamit.

Nuk duhet frikësuar askujt, nuk nevojitet për t'iu nënshtruar askujt, nuk duhet nënshtruar asnjë okupatori, asnjë udhëheqësi, pa marrë parasysh nga vjen ai.

Askush nuk lejohet të jetë më prioritar se feja e Allahut të Lartmadhëruar. Secili do të jep llogari në fenë e Allahut.

Qoftë i kënaqur Allahu me Ebu Bekri Sidikin dhe e kënaqtë atë, na pajistë me dashuri dhe mbështetje me veprimtarinë e Tij, na bashkoftë me atë, me Pejgamberin tonë s.a.v.s., me pejgamberët tjerë, të sinqertit, dëshmorët dhe të gjithë besimtarët e drejtë në xhenetet më të larta.

Atëherë, kur disa fise arabe refuzuan dhënien e zekatit, penguan zekatin dhe ishin përgatitur për të tradhtuar fenë, Ebu Bekri Sidiki u ngrit si luani i tërbuar, i vendosur që t'i luftojë ata. Kur sahabët i propozuan që t'i lë ata edhe pse refuzojnë dhënien e zekatit, dhe që t'i përvetësojë gradualisht duke vendosur imanin në zemrat e tyre, në mesin e propozuesve ishte edhe Omeri r.a., por shikoni çfarë

ka qenë qëndrimi i Ebu Bekri Sidikit, ai kategorikisht ka refuzuar:

Ebu Hurejre r.a. tregon se kur vdiq i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe halife u zgjidh Ebu Bekri, disa prej arabëve u larguan nga feja. Omeri r.a. i thotë: “*Si mund t’i luftosh njerëzit kur i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: Jam i urdhëruar t’i luftoj deri sa të thonë*

LA ILAHE IL-LALLAH,, dhe ata të cilët thonë

LA ILAHE IL-LALLAH për mua është e ndaluar pasuria e tij, vrasja përpos me të drejtë dhe në obligim për Zotin. Ebu Bekri thotë: Për Zotin do t’i luftoj ata, të cilët bëjnë dallim në mes të namazit dhe zekatit, sepse zekati është e drejtë e pasurisë. Për Zotin kush më pengon një litar të cilën e ka lënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. unë do ta luftojë atë. Omeri r.a. thotë: Për Zotin, aty e kam kuptuar se Allahu ia ka zgjeruar kraharorin Ebu Bekrit për luftë dhe e kam kuptuar plotësisht se ai ka pasur të drejtë”.

(Revahul xhemaatu, përpos Ibni Maxhes, ky tekst është tekst i Buhariut)

Vëlla!!

Kjo është fortësi e imanit në Allahun e Lartmadhëruar, të cilin nuk mund ta mposht kurrë asnjë njeri.

Që nga momenti kur kemi filluar të humbim fuqinë e imanit në Allahun e Lartmadhëruar dhe jemi larguar nga rruga e Tij, nga ligjet e Tij madhështore, kanë ra

mbi ne nënçmimet, poshtërimet pasi që veç më herët kemi qenë më të lartë, të fortë, ndërsa të tjerët të ultë dhe të poshtëruar, poshtërimi më i madh është se i jemi nënshtruar poshtërimit.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BILAH

Omer bin el Hatabi r.a.

Kur e ka pranuar islamin e ka kuptuar forcën, krenarinë e islamit, vlerën e madhe të tij dhe pas një kohe të shkurtër ai ka kërkuar nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: “A nuk jemi në rrugë të drejtë o i Dërguar i Allahut s.a.v.s. i thotë”. I thotë: “Po gjithsesi”. – Atëherë pse të fshihemi dhe kanë dalë haptazi të rreshtuar në dy rreshta në krye të njërit rresht ishte Omeri r.a., ndërsa në krye të rreshtit tjetër ishte Hamza r.a. Kur hyrën në xhami, kurejshitet shohin se në mesin e tyre ishin Hamza dhe Omeri r.a., i kaplon mërzia dhe frika e madhe. Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. atë moment e ka quajtur momenti i Omerul Farukut.

Abdullah bin Mes’udi r.a. ka thënë:

“Gjithmonë kemi qenë krenarë dhe më të fortë prej momentit kur Omeri e ka pranuar islamin”.

(Sahihul Buhari, 3574)

Pak para se të çlirohej Mesxhidi Aksa-ja prej muslimanëve e kanë dërguar Ebu Abidetin te Emiri i besimtarëve për t’i treguar Omer bin Hatabit r.a. për

të shkuar dhe për t'ia dhënë atij çelësat e Mesxhidi Aksa-së. Omeri r.a. arrin në Sham, prej aty nevojitej për ta kaluar lumin, Omeri r.a. zbret prej kafshës së tij dhe e kalon ujin në këmbë. Ebu Abidi i thotë: Për banorët e këtij vendi ke lënë përshtypje shumë të mirë (ka pasur për qëllim romakët), sepse ke vepruar kështu e kështu Omeri r.a. e vendosë dorën në kraharonin e tij dhe i thotë: Po kush tjetër ta thoshte këtë o Abidete, po a e din ti se ju keni qenë populli më i poshtëruari, më i nënçmuari, më i vogli, ndërsa Allahu juve ju ka ngritur dhe ju ka privilegjuar me islam, dhe çdo ngritje, zhvillim që do të kërkon, përpos islamit, ju prapë do të ktheheni të nënçmuar dhe të poshtëruar.

Omeri r.a. kaloi kodrinat në drejtim të rrugës Ilija, me devenë e verdhë, kryeshtruar edhe pse dielli përcëllonte shputat e tij preknin për toke, e jo hipur në deve. Këmbët e tij ecnin paralel me devenë e tij, të cilën e frenonte dhe e mbante lidhur për dore në litar. Në anën tjetër kishte çantën, që kur hipte në deve e kishte samar, ndërsa kur zbriste e shfrytëzonte për jastëk; kishte veshur një këmishë, mëngët e së cilës ishin të shqyera. Kur arriti në vendin e duhur tha: Më thirrni të parin e popullit.

E thirrën Gjelmusin, i cili i tha: Ti je mbret i arabëve, ndërsa në këtë vend e kanë mëri devenë, po të ishe i veshur ndryshe nga këto rroba, përndryshe romakët do të të urrenin dhe do ta kishin zënë për të madhe.

Omeri r.a. i tha : Ne jemi popull, të cilin Islami e ka ngritur dhe nuk duam që ndryshe të jetë”.

(El-Bidaje ven-Nihajeti, li Ibni Kethirë, 61/7)

Vëllezër!! T’ua mësojmë fëmijëve tanë fjalët e Omer bin El-Hatabit r.a., fjalë, të cilat meritojnë të shkruhen me shkronja të arta, meritojnë që çdo musliman t’i mësojë përmendësh, t’i ruajë në gjoksin e tij dhe të veprojë sipas atyre:

“Vërtet, ju keni qenë populli më i nënçmuar, më i poshtëruari, më i vogli, ndërsa Allahu ju ka ngritur dhe ju ka privilegjuar me Islam, dhe çfarë do privilegje, apo ngritje kërkon, përpos Islamit, Allahu prapë do t’ju nënvlerësojë dhe do t’ju nënçmojë”.

Nuk është ngritje, krenari, mburrje me rroba të shtrenjta, apo me automjete luksoze, apo me ndërtesa të mëdha. Mburria, krenaria është për Allahun, me Allahun, në fenë e Allahut, duke iu përmbajtur fesë së Allahut dhe angazhimi, xhihadi për të, dhe ruajtja e tij.

Esma Bin Ebi Bekri r.a.

I kishte tetëdhjetë vite, djali i saj quhej Abdullah bin Zubejri, i cili luftonte Haxhaxh bin Jusuf Thekafijun, dhe Haxhaxhi e vrau atë, ndërsa trupin e tij e ka lënë të ngujuar tri ditë në qendër të Mekës. Njerëzit menduan se Esma r.a. do të shkonte

dhe do të kërkonte, dhe t'i përulej Haxhaxhit për t'ia zgjidhur, dhe ta merr kufomën e birit të saj. Mirëpo ajo nuk ka shkuar te ai, ajo ka pasur shpirt të jashtëzakonshëm. Ajo ka pasur durim dhe ka pasur bindje se djali i saj do të shpërblehet te Allahu i Lartmadhëruar. Ajo ka pasur besim të fortë te Allahu i Lartmadhëruar se nuk do t'ia humb shpërblimin e djalit të saj, ajo ka duruar për humbjen e birit të saj.

Haxhaxhi shkon te ajo dhe i thotë: A e din se çka i kam bërë djalit tënd. Ajo i kthen me zë të guximshëm: *“Të kam parë se si ti ia ke shkatërruar atij këtë botë dhe ai ta ka shkatërruar ty botën tjetër”*. Cili prej nesh ka moral të këtillë?!

Rebiiun Bin Amir

Kur janë takuar ushtria muslimane me ushtrinë persiane, udhëheqësi persian, Rustemi e dërgon te Seab bin e Ebi Vekasi r.a. një delegacion, i cili dëshironte një njeri të mençur për ta pyetur për islamin dhe muslimanët. Ai e dërgoi Sead bin Rebij bin Amirin r.a. për ta takuar dhe t'ia mësojë Islamin.

Persianët dëshironin që t'ia tregonin atij luksin e tyre, lartësinë dhe pasurinë e tyre për ta nënçmuar, dhe poshtëruar, për këtë arsye ata e stolisën sallën e kuvendit të tyre me ar, argjend, stoli mëndafshi, me sende të çmuara dhe të shtrenjta. Rebij e kuptoi qëllimin e tyre, sepse ai ka qenë njeri i fuqishëm, me

imanë dhe bindje të fortë në Allahun, dhe për fitoren e Islamit, dhe muslimanëve.

Rebiu hyri me rroba të vjetra dhe modeste, me teshë dhe kalin e tij të vogël sa që edhe këmbët i shkonin për toke hipur mbi kalë. Zbret prej kalit dhe e lidhë kalin e tij për sendet e stolisura prej ari, dhe iu afrohet parisë persiane me armë, mburojën e gjoksit dhe kapelën mbi kokë. I thanë atij: Leri armët për toke. – Iu thotë: Unë nuk kam ardhur me dëshirën time, por me kërkesën tuaj, nëse dëshironi kështu, në rregull, nëse jo, atëherë kthehem.

Shiko se çfarë fortësie ka pasur Rebiu, i mbështetur fortë në Allahun e Plotfuqishëm dhe të Falënderuar.

Rustemi i thotë: Lëreni si të dëshiron. Ai mbështetet mbi kolltukët, të cilat ishin prodhim romak, të stolisura në vendkuvendimin e tyre dhe i shqyen ato. Ata e pyetën: Përse keni ardhur?

U përgjigj: “Allahu na ka caktuar për t’i nxjerrë njerëzit (prej tyre) kush dëshiron prej adhurimit të robit në adhurimin e Krijuesit dhe prej ngushtësisë së kësaj bote në botën tjetër të zgjeruar, dhe prej feve të kota në drejtësinë islame. Ne jemi të dërguar për ta përhapur fenë e Tij te njerëzimi, që t’i thërrasim ata. Kush e pranon dhe i përgjigjet thirrjes kthehemi, e kush refuzon e luftojmë deri në fund, ose deri në momentet ashtu siç e ka premtuar Allahu.

Thanë: Po cili është premtimi i Allahut?!

Ai u përgjigj: Xheneti atij i cili vritet duke luftuar refuzuesin dhe triumfi atij i cili mbijeton.

Rustemi i thotë: Ju kam dëgjuar dhe ju kam kuptuar, por a ka mundësi që ta vonojmë këtë çështje deri sa ne të konsultohemi mes vete, dhe deri sa ju të konsultoheni mes vete. Po. Por sa po dëshironi afat, një ditë apo dy ditë?

Rusteimi i thotë: Jo, kjo është shumë pak, ngase na nevojitet konsultim me të gjithë udhëheqësit e popullit tonë.

Rebiju i thotë: Nuk kemi dëgjuar ndonjëherë nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që t'i japim afat më shumë se tri ditë armikut, kur jemi në fushëbetejë. Shiko çështjen tënde dhe të tyre dhe kemi afat tri ditë.

Rustemi i thotë: A ju jeni kryesori për vendimmarrje? – Jo, por muslimanët janë si një trup, të barabartë janë i pari me të fundin.

Rustemi takohet me udhëheqësit e popullit të tij dhe u thotë: A keni parë ndonjëherë njeri më të vendosur se ky? Ata iu përgjigjen: Jo, kurrë jo, por a nuk po i sheh rrobat e tij. Rebiu (Rustemi) u thotë: “Mjer për ju, mos shikoni në rroba, por shikoni fjalët, mendimet dhe të kaluarën, sepse arabët nuk iu kushtojnë rëndësi rrobave, e ushqimit, por i kushtojnë rëndësi llogaritjes së veprave të tyre”.

(El-Bidaje ve nihaje li ibni Kethir, 40/7)

Vëlla!

Rustemi është tronditur me fuqinë, krenarinë, fisnikërinë, trimërinë dhe oratorinë e Rebiut r.a.. Ai do ta kishte pranuar dhe do të ishte dorëzuar, po mos t'iu kishte frikësuar trazirave, dhe shkatërrimeve nga të tjerët.

Bëhu krenar në Allahu, do të të respektojnë të gjithë njerëzit, sepse krenaria i takon vetëm Atij, Një të Vetmit, i Cili nuk ka ortak as rival.

El Muëtesim Bilahi – Halife Abasit

Kur është poshtëruar dhe është nënçmuar një grua muslimane në perandorinë Romake, e ajo ka kërkuar ndihmë prej Allahut, pastaj prej Halifës së muslimanëve të atëhershëm, i cili ishte El-Muëtesim bilahi - Halife Abasit, duke i thënë: “O Muëtesim, më ndihmo!”

El-Muëtesim e ka dërguar një shkresë ku thoshte:

“Nga Muëtesim bilahi – Halife i muslimanëve te Nikfor Kelbi Romak: Ma liro dhe ma dërgo gruan, të pakeqpërdorur dhe të padëmtuar, përndryshe ushtari i parë do të jetë tek ti, e i fundit tek unë.

Vëlla!!

Shembuj të krenarisë në Allahun janë të panumërta

Rruga deri te kthimi i krenarisë në umetin

Rruga për t'ia kthyer krenarinë umetit është bindja e fortë në Allahun, vendosmëria se krenaria e ka vetëm një mbështetje, vetëm një bazë, e ajo (mbështetje-bazë) është Allahu i Lartmadhëruar.

Rruga për t'ia kthyer krenarinë umetit është imani në Allahun e Lartmadhëruar, besimi në fuqinë e Tij, dhe mbështetja në Allahun, kërkimi i ndihmës vetëm prej Tij. Rruga për t'ia kthyer krenarinë umetit është përmbajtja në fenë e Tij, vendosmëria në kryerjen e urdhrave dhe largimi prej të këqijave.

Rruga për t'ia kthyer krenarinë umetit është besimi në krenarinë e umetit, fuqinë e tij dhe ardhmëria perspektiva është e umetit: ***“Ju jeni umeti më i mirë i zgjedhur për njerëzimin”***. (Ali Imran, 110)

Rruga e krenarisë së umetit është vetëbesimi se jeta, furnizimi nuk është në duar të ndonjë njeriu, apo të ndonjë shteti, por në duar të Allahut Një, i Cili nuk ka rival as ortak.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

Në cilën ditë me i ikur vdekjes?! Ditës kur ma ka caktuar Allahu të vdes apo ditës kur nuk më është caktuar vdekja. Nëse më është caktuar që mos të vdes atë ditë, pse të iki prej vdekjes, por nëse më është caktuar të vdes në ndonjë ditë, a ka mundësi të iki?!

Vështro dhe analizo!

I është thënë një gruaje: Kërko nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që mos ta dërgojë burrin tënd në luftë, sepse ke nevojë që ai të të ushqejë (furnizojë) ty dhe familjen. Ajo u thotë atyre: Unë e di se burri im është i furnizuar, ndërsa nuk e njoh si furnizues, prandaj nëse shkon i furnizuari mbetet Furnizuesi.

Vini re!!

Krenaria nuk do të thotë **kryeneçësi, apo kokëfortësi.**

Për këtë arsye fjala fuqi vjen bashkërisht me fjalën urtësi apo falje gabimi, sikurse në ajetin fisnik:

“... i Fuqishëm, i Urtë”. (El-Enfal, 67)

apo ajeti fisnik:

“... i Fuqishëm, Falës i gabimeve”.

Ke kujdes e mos iu bën padrejtësi njerëzve vetëm pse ke forcë e fuqi. Forcë do të thotë: **të jesh i matur kur ke mundësi të dënosh**, por në të njëjtën kohë, forcë do të thotë edhe kur je modest, por i panënshtuar.

Shembull:

Një njeri më ka shkruar një letër ku ankohej:

Drejtori im më nënçmon për së tepërmi. Si të veproj – a të jap dorëheqje, apo jo?

Ia ktheva përgjigjen: Nevojitet për ta vendosur në peshojë forcën dhe urtësinë. Çështjen e parë që duhet

ta bësh është që kur drejtori të nënçmon, ti duhesh që të mos hidhërohesh dhe të jesh i matur, mirëpo nëse ai e përsëritë dhe shpesh të nënçmon, patjetër duhet ta stoposh kur të sillet armiqësisht në mes të raporteve drejtor-nëpunës. Pra, të mos dërgosh ankesa te eprorët e tij dhe ta akuzosh apo të tregosh sjelljet e tij ndaj teje, pra të shpifësh, me fjalë tjera ta tradhtosh.

Ta dish se krenaria është besim, urtësi dhe mençuri. Kur të zhvishet fortësia, krenaria prej Imanit, kalon në mendjemadhësi dhe tradhti. Zoti na mbrojt prej kryelartësisë dhe tradhtisë.

Kur të zhvishet fortësia, krenaria prej urtësisë dhe mençurisë, kalon në çmenduri, ahmak.

Muslimani duhet ta gjejë mesataren, as të mos jetë kryelartë, por as i mashtruar, as ahmak, as të mos nënshtrohet, e të nënçmohet tejmasë, por as të mos kalojë në kryelartësi tejmasë.

Mesatarja dhe maturia! Mesatarja dhe maturia!

Në fund, shpresoj tek Allahu Hnnan e Mennan që nëpërmjet këtij mesazhi të bëjë dobi te secili lexues, ashtu siç shpresoj që Allahu do të na pranojë të gjitha veprat e mira, që t'i peshojë në vagën e të mirave dhe të na fshijë të këqijat dhe lajthitjet, ashtu siç shpresoj që të më falë për mangësitë dhe harresat. Dëshmoj para Allahut dhe para të gjitha krijesave se për atë që e kam qëlluar është prej diturisë që më ka mësuar Zoti

im dhe i Dërguari i Tij s.a.v.s., ndërsa çka ka qenë prej lajthitjeve, gabimeve, harresës ka qenë prej vetvetes sime dhe prej shejtanit. Allahu dhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s. janë të pastër.

E lus Allahun le të mi falë gabimet, të m'i fshijë të metat, lajthitjet dhe gabimet nga unë dhe nga lexuesit.

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.
21. “Kurbani i ud'hijes, hedjit, nedhrit, dhe i vasietit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori *Muhamed Sajim*);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori *Jusuf Kardavi*);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori *Abdurrezak Nufel*);
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori *Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori *Abduhu Abas El-Velidi*);
6. “Vlera e kohës” (nga autori *Amër Halid*);
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori *Amër Halid*);
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori *Amër Halid*);
9. “Pendimi” (nga autori *Amër Halid*);
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori *Amër Halid*);
11. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga *Amër Halid*);
12. “Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga *Amër Halid*);
13. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët *Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir*).
14. “Bidndja e thellë në Allahun” (nga autori *Amër Halid*);
15. “Superfuqia në Allahun” (nga autori *Amër Halid*).